



Prishtinë, 20 dhjetor 2018
Kodi i ZRRE-së: V_1086_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 15 , dhe Dispozitat e Nenit 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 9 të Kodit të Rrjetit – Kodit të Planifikimit; dhe
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT Sh.A) të datës 26.10.2018 për shqyrtim dhe miratim të dokumentit: *Plani i Adekuacisë së Gjenerimit 2019 - 2028*,

në seancën e mbajtur me datë 20.12.2018, nxori këtë:

PËLQIM

- I. Ipet Pëlqimi për publikimin dhe shfrytëzimin e dokumentit “Plani i Adekuacisë së Gjenerimit 2019-2028”.

Arsyetim

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 26.10.2018 ka pranuar dokumentin “Plani i Adekuacisë së Gjenerimit 2019-2028” nga KOSTT me kërkesën për shqyrtim dhe miratim të dokumentit. ZRRE ka dhënë komentet e veta të cilat janë përfshirë në dokument, si dhe janë sqaruar çështjet specifike të dokumentit dhe paqartësi të ndryshme. Pas përfshirjes së komenteve të arsyeshme nga palët, dokumenti është dërguar me datë 04.12.2018, si version final për rishikim në ZRRE.

Pas analizimit të dokumentit përfundimtar, dhe përfshirjes së komenteve, ZRRE konsideron se dokumenti “Plani i Adekuacisë së Gjenerimit 2019-2028” i përmbush kriteret për publikim dhe jep pëlqimin për këtë.

- II. Pëlqimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.



Pëlqimi i dërgohet:

- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i ZRRE-së

Arsim Janova, u.d. kryesuesit

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar